

# RELACION ARKITEKTONIK

*“RIKONSTRUKSION I OBJEKTIT EKZISTUES, SHTESE ANESORE  
DHE GODINA E RE E KALCETOS ,SHKALLET E EMERGJENCES,  
DHE MURI RRETHUES NE GODINEN E SHKOLLES "SHUSHICE"-  
BASHKIA ELBASAN”*



Shoqeria “Ersi/M” shpk

ADMINISTRATOR

Gezim Goxhaj

ARKITEKT

Erald Goxhaj Lic. A.2613

## VENDODHJA E SHESHIT

Përbërja e njësisë është me karakter banimi dhe shërbime. Zona ka tipologji ndërtimi, me objekte tip vila individuale të realizuara në vite të ndryshme dhe lartësi katesh që variojnë deri në 1-3kate maksimumi.



Sheshi I objektit arsimor ndodhet ne Njesine Strukturore 8/184 Bashkia Elbasan.

- ZONA E NDERTIMIT – ELBASAN
- OBJEKTI EKZISTUES - shkolla 9-vjeçare e Fshatit Shushice,
- ZHVILLUESI - Bashkia Elbasan
- SIPERFAQE E TOKES QE ZHVILLOHET - 4843 m<sup>2</sup>
- SIPERFAQE TOTALE NDERTIMORE E OBJEKTIT – 2415 m<sup>2</sup>

## ORTOFOTO E OBJEKTIT



Vendodhja e objektit te investimit eshte ne fshatin Shushice, Njesia administrative Shushice, Bashkia Elbasan.

### **Gjendja faktike**

Shkolla 9-Vjeçare dhe kopeshti "Shushice" ndodhet ne njesine Administrative Shushice, ne fshatin Shushice te bashkise së Elbasan. Ndertesa eshte tre kateshe me lartesi rreth 11.07m, me ekspozim te ambientit te klasave ne drejtimin veri-lindje dhe jug-perendim. Eshte nje objekt i ndërtuar ne vitin 1984, me mbulese me cati . Objekti kryesisht eshte ne gjendje te mirembatur dhe sipas informacioneve nuk ka patur rikonstruksione pergjate viteve.

### **Me poshte eshte dhene ne menyre te permbledhur situata e nderteses:**

Parcela, në të cilën ndodhet objekti i cili i nënshtrohet ndërhyrjes, së parashikuar nëpërmjet kësaj detyre projektimi, ndodhet në Njësinë Administrative Shushicë, përgjatë rrugës "Pazaret", në parcelën kadastrale me nr. pasurie 270/8 dhe 270/9, në zonën kadastrale 3445. Topografia e zonës është e rrafshët. Parcela ka një formë afërsisht kuadratike, është e kufizuar me mur rrethues dhe ka një sipërfaqe totale prej 4843 m<sup>2</sup>. Hyrja për në hapësirën e brendshme të shkollës mundësohet përmes 2 rrugicash në pjesën veri-lindore dhe jug-perendimore të saj, e cila nëpërmjet një rrugice të lidh me rrugën kryesore ekzistuese. Terreni është relativisht i sheshtë dhe me një pjerrësi të ulët në drejtimin perendimor. Nga analiza në terren, studimi gjeologjik dhe ai sizmik, nuk janë evidentuar probleme lidhur me gjeologjinë dhe shtresat.


- ***Gjendja e objektit ku do të ndërhyhet,***

Objekti ekzistues nuk plotëson kushtet dhe normat e nevojshme për një proces mesimdhënie, duke listuar si problematika kryesore:

- Problematika të komfortit termik të hapësirave të brendshme të shkollës, për shkak të mungesës së izolimit termik dhe sistemit kapote të mureve dhe dritareve
- Probleme me lagështirën e brendshme, për shkak të filtrimit kapilar
- Probleme të çatisë, për shkak të depertimit të ujerave të shiut
- Mungesë të sistemeve të pershtatshme të HVAC
- Nevoje për përmirësimin e linjave të brendshme të furnizimit me ujë dhe shkarkimit
- Nevoje për rritjen e efikasitetit të rrjetit energjitik të shkollës
- Krijimi i një strukture tërësisht të re për palester

Shkolla është aktualisht në përdorim nga 389 nënes (199 djem dhe 190 vajza) dhe 21 mësues.

FOTO TE GJENDJES EKZISTUESE:



Nisur nga fotot e mesiperme eshte e domosdoshem rikonstruksioni i objektit per nxenesit e kesaj shkolle .

Ky projekt zgjidh perfundimisht problemin e zhvillimit te procesit mesimore ne kushte optimale per nxenesit qe e frekuentojne shkollen. Shkalla e ndikimit te tij eshte ne dy plane .Ne planin intelektual rrit perqindjen e nxenies nga ana e nxenesve , ndersa ne planin social shton aktivitetet fizike dhe sportive per nexenesit dhe komunitetin duke l perfshire me teper ne to .



- OBJEKTI EKZISTUES – shkolla 9-vjeçare e Njësisë Administrative Shushice,
- ZHVILLUESI - Bashkia Elbasan
- SIPERFAQE E TOKES QE ZHVILLOHET – 4843 m<sup>2</sup>
- SIPERFAQE TOTALE NDERTIMORE E OBJEKTIT - 2415 m<sup>2</sup>

- ***Numri i kateve,***


Godina ekzistuese eshte tre kateshe, po keshtu edhe shtesa e cila do te pozicionohet ne zonen ku mendohen prishje murature, ndersa palestra eshte rreth dy kate lartesi.

- ZONA E NDERTIMIT - Fshati Shushice
- OBJEKTI I RI – shkolla 9-vjeçare e Njësisë Administrative Shushice,
- ZHVILLUESI – Bashkia Elbasan
- SIPERFAQE E TOKES QE ZHVILLOHET – 4843 m<sup>2</sup>
- SIPERFAQE TOTALE NDERTIMORE E OBJEKTIT – 2415 m<sup>2</sup>
- SIPERFAQE KATI PERDHE-1083m<sup>2</sup>
- SIPERFAQE KATI I PARE-666m<sup>2</sup>

Objekti ne fjale, eshte “Shkolla 9- Vjecare Shushice “, shkolle me ciklin arsimor parashkollore, fillore dhe nente-vjecare.

Gjendja ekzistuese e shkolles 9-vjecare Shushice eshte ne gjendje te mirembajtur eshe pse pa rikonstruksione te mirefilla , shtojme faktin qe pas termetit nuk ka pasur asnje nderhyrje. Kushtet higjenike ne shkolle dhe tualetet jane ne gjendje qe kerkojne nderhyrje emergjente dhe uji l ngrohte ne nyjet sanitare nuk sigurohet nga shkolla.

## PLANSISTEMIM I OBJEKTIT EKZISTUES



Kerkesat teknike kundrejt projektit arkitekturor.

Me qellim rritjen e eficenses energjitike te godines projekti parashikon veshjen termoizoluese te te gjithë kapsules veshese te jashtme te godines. Projekti arkitekturor merr ne konsiderate pershtatjen e objektit per personat me aftesi te kufizuara, referuar kategorizimeve te kufizimeve te ndryshme. Materialet e propozuara per te gjithë elementet ndares dhe veshes, termoizolues, hidroizolues etj., jane bashkekohore, dhe plotesojne kushtet

Rendesi I eshte kushtuar akustikes se ambienteve, izolimit nga zhurmat, luhatjet e temperatures dhe lageshtires.

## PLANSISTEMIM I OBJEKTIT TE RI



Shkolla eshte e organizuar ne menyre te tillle qe te jete funksionale dhe te permbush te gjitha objektivat mesimore te nxenesve.

Duke u bazuar ne *Standartet e Projektimit te Shkollave* dhe mundesite qe ofron pozicioni gjeografik eshte bere e mundur organizimi I hapësirave sic eshte paraqitur ne planvendosje. Ne hyrje te shkolles do te sistemohet nje verande hyrese , e cila sherben si nje “hinke mbledhese” qe do te perdoret per rreshtimin e nxenesve para hyrjes ne mesim, aktivitet sportive si edhe aktivitete te ndryshme festive. Duke qene se eshte nje sipërfaqe e konsiderueshme te lejon nje mireorganizim dhe lireshmeri ne varesi te qellimit te sherbimit qe vendoset.

Sipërfaqja totale ne dispozicion te shkolles eshte 4843m<sup>2</sup>. Nje sipërfaqe e tille na ka dhene akses per ndertimin e nje palestere teresisht te re duke respektuar legjislacionin urbanistik ne fuqi, distancat nga objekti ekzistues distancat nga kufiri I prone si dhe distancat nga akset e rruges. Godina do te jete nje objekt nje katesh me lartesishte e parashikuara per palestrat shkollore.

Shkolla eshte e aksesueshme nga rruge automobilistike jashte portes se rrethimit gje e cila jep nje komoditet ne transportin e femijeve si dhe krijon nje vizibilitet te kendshem.

Propozimi I nje fasade ku eshte krijuar mundesia e mbajtjes se mbulimit me cati dhe trajtimi I dritareve dhe fasades me korniza ekzaltuese dhe hijezues sa te kendhsem edhe funksional.

Per organizimin e hapësirave te brendshme mund te themi qe kemi qendruar rigoroz ndaj standarteve te projektimit dhe komoditetit ne funksion te nxenesve.


Persa I perket Standarteve te Projektimit kemi respektuar hapësirat e klasave, menazhimin e funksionalitetit te ambjenteve duke perfshire numrin e nevojshem te klasave, numrin e nevojshem te Laboratoreve, Tualeteve si dhe pershtatje interior te klasave ne funksion te qellimit mesimor.

Projekti parashikon nderhyrje rikonstruksioni dhe riorganizimi ne godinen ekzistuese si dhe ndertim te nje shtese te re per palestren ne dy kate lartesi ,bashkuar ambienteve te saj ndihmese po tre kate sa godina ekzistuese, ne ambientet ku pas vleresimit vendosem te kemi prishje murature, ky zonim te zevendesohet me nje strukture te re te qendrueshme me funksion kryesisht tualete ne secilin kat.

Ne godinen ekzistuese punimet do te konsistojne ne:

- Ne katin perdhe eshte dhene zgjidhja e vecimit te ambienteve te kopeshtit teresisht, duke i pajisur me tualetet e veta dhe hyrjen perkatese gjithashtu.Kopeshtit te vecuar I eshte pajisur edhe daljen e emergjences e evidentuar
- Pjesa me madhe e klasave te ciklit te fillores jane perqendruar ne Katin e pare. Hapesira dhe pozicionimi i tyre eshte bere ne baze te Standarteve te Projektimit. Permasimi i tyre eshte pothuajse i njejte per te gjitha, dhe rehatojne te njejtin kapacitet nxenesish.
- Shtuar ambientit sportiv te mbyllur ku jane vendosur ambientet ndihmese , dushe ,depo,depo per bazen materiale, doma zhveshjesh , per femijet dhe stafin perkates.Ne objektin ekzistues jane sistemuar tualetet si dhe shtuar numri I tyre ne cdo kat.Pergjate gjithe projektimit eshte menduar per personat me aftesi te kufizuara, qe nga rampa hyrese, tek tualetet dhe klasat burimore ne seclin kat.


## PLANIMETRIA E KATIT PERDHE (ekzistuese)



Ne katin perdhe ekzistues kemi ambiente si:

- 3 klasa kopeshti
- 3 klasa te pergjithshme
- Aneks klase
- Tualete femra- meshkuj
- Tualete stafi
- Dhome fiskulture
- Veranda hyrese
- Korridor kati perdhe
- Klase burimore
- Verande hyrje


## PLANIMETRIA E KATIT TE PARE



Per sa I perket Katit te pare kemi ekzistuese keto ambiente:

- 7 klasa te pergjithshme
- 1 laborator smart lab
- Drejtori
- Korridor kati I pare
- Grupi I shkalleve
- Biblioteke


## PLANIMETRIA E KATIT TE DYTE



Per sa I perket Katit te dyte kemi ekzistuese keto ambiente:

- 7 klasa te pergjithshme
- 1 laborator smart lab
- Salle mesuesish
- Nendrejtori
- Korridor kati I dyte
- Grupi I shkalleve

## PLANIMETRIA E PROPOZUAR (kati perdhe)



Ne ndryshim nga gjendja ekzistuese , ne projektin e propozuar eshte shtuar nje palester e mbyllur ,e nevojshme per permiresimin e mesimdhenies , si dhe eshte sistemuar terreni I jashtem i hapur ekzistues. Shtuar ambientit sportiv te mbyllur jane vendosur ambientet ndihmese , dushe ,depo,depo per bazen materiale, doma zhveshjesh , per femijet dhe stafin perkates.Jane sistemuar tualetet si dhe shtuar numri I tyre .Pergjate gjithë projektimit eshte menduar per personat me aftesi te kufizuara, qe nga rampa hyrese, tek tualetet dhe klasat burimore ne seclin kat.

Ne katin perdhe eshte dhene zgjidhja e vecimit te ambienteve te kopeshtit teresisht, duke i pajisur me tualetet e veta dhe hyrjen perkatese gjithashtu. Kopeshtit te vecuar I eshte pajisur edhe daljen e emergjences e evidentuar.

Numri I ambjenteve dhe hapsira e lene per secilen permbush te gjitha qellimet e nje Kopshti te mire menaxhuar. Ne lidhje me organizimin e ambienteve totale te shkolles eshte marre parasysh dhe fluksi I femijeve qe ndodhet ne kete zone, si dhe parashikimi I rritjes vjetore te numrit te tyre.

Holli ka nje siperfaqe te konsiderueshme kjo per faktin e rendesise qe ka. Pervec efektit arkitektonik rendesia e holli konsiston edhe ne permbushjen e evidentimit te aktiviteteve te ndryshme shkollore.


Tualetet jane lene vetem ne katin perdhe per vajzat dhe djemte e shkolles.

#### AMBIENTET E PROPOZUARA SIPAS NORMATIVAVE:

##### -Kati perdhe

- 4 klasa kopeshti
- Korridor kopeshti
- Verande kopeshti
- Tualete kopeshti
- Holl
- Korridor
- Laborator bio-kimi
- Depo laborator
- 2 klasa
- Mjek +psikolog
- Klase vizatimi
- Tualete fema-meshkuj
- Tualete stafi
- Tualete PAK
- Dhoma zhveshje
- Dhome mesuesi fiksulture
- Depo materialesh
- Palester e mbyllur

## PLANIMETRIA E PROPOZUAR (kati i pare)




Jane shtuar vetrata xhami ne kontrast me carjet ekzistuese minimaliste ne ndertese.Keto vetrata shtojne cilesine e experiences pamore dhe te ndervepruarit si jashte-brenda por dhe brenda-jashte. Pergjate gjithë objektit kemi sigurim te ambientit ndaj zjarrit sipas standartit , si dhe shkallen e emrgjences duke e fortifikuar kete dhe me rrjete per nje siguri te shtuar.

## AMBIENTET E PROPOZUARA SIPAS NORMATIVAVE

-Kati I pare

- 8 klasa
- Tualete femra-meshkuj
- Tualete stafi
- Biblioteke
- Laborator TIK
- Drejtori
- Klase Burimore
- korridor

PLANIMETRIA E PROPOZUAR (kati i dyte)



## AMBIENTET E PROPOZUARA SIPAS NORMATIVAVE



### -Kati I dyte

- 8 klasa
- Tualet femra-meshkuj
- Tualet stafi
- Salle multifunksionale
- Laborator TIK
- Nendrejtori
- Salle mesuesish
- Korridor



Pjesa me madhe e klasave eshte perqendruar ne Katin e pare dhe te dyte. Hapesira dhe pozicionimi i tyre eshte bere ne baze te Standarteve te Projektimit. Permasimi i tyre eshte pothuajse i njejte per te gjitha, dhe rehatojne te njejtin kapacitet nxenesish.

Drejtoria dhe ambientet e tjera administartive te stafit jane vendosur ne katin e dyte dhe te trete duke qene se fluksi me larte eshte ne kete kat. Keshtu behet e mundur nje mire menaxhim nga ana e tyre.

## FASADAT EKZISTUESE



## FASADAT E PROPOZUARA



Fasadat e ndertesës kanë një sipërfaqe të konsiderueshme vetratë. Kjo siguron hapësira drite në objekt mjaft të rëndësishme si efekt arkitektonik dhe funksional. Gjithashtu vëhet re se, edhe pse objekti ka çarje shumë mire të shpërndara (ndricimi natyral është mjaft i mirë), perseri është menaxhuar mbajtja e tyre minimaliste në permasa duke iu pershtatur zonës.

Fasada është propozuar të bëhet me veshje kapote, ku ngjyra kryesore e përdorur është bezhe e ngrohtë me kod DC-3046-1 dhe ngjyrat e tjera të detajeve me kode përkatesisht:

- e kuqja DC-4562-5, e verdha DC-5034-8, e gjelbra DC-5276-9, violeta DC-4145-4, portokallia DC-4967-7, dhe ngjyra bojeqielli me kod DC-3892-3.



## NGJYRAT E PERDORURA

Per analizimin e ngjyrave te perdorura ne fasade eshte marre ne studim Target groupi me I mundshem I perdoruesve te objektit , pra nxenesit.

Ngjyrat ndikojne te nxenesit ne menyra te ndryshme duke i bere te ndihen te lumtur, te mēzitur, te qete ose meditative. Ngjyrat gjithashtu ndikojne ne perceptimin e madhesise se mjedisit, komoditetit etj.

Ngjyra mund te ndryshojte perceptimin tone per dimensionet dhe distancen.

Per kete arsye perdorimi i tyre ne shkolla eshte i domosdoshem, por duke marre ne konsiderate ndikimet e tyre te femijet.

\* E kuqja lidhet me diellin dhe mund te shtojte rrahjet e zemres. Eshte nje ngjyre mjaft stimuluese dhe simbolizon veprimtarite dhe deshiren per jeten, si dhe ngrohtesi.

- Portokallia eshte nje version me pak i forte se e kuqja. Krahasohet me gezimin ge ngjall e verdha. Jep gezim dhe ndihmon ne kapercimin e traumave. Perfaqëson natyren me diell dhe te bukur.


- Bluja ne terapine e ngjyrave njihet singjyra e tranzicionit, Bluja ofron perkraheje dhe mbrojtje dhe eshte ngjyra e paqes, qetesise dhe zgjuarsise.
- E gielbra eshte ngjyra e rinise, rritjes, shpreses, gezimit, jetes dhe freskise. Eshte Githashtu ngjyra e harmonise dhe ekuilibrit.
- E verdha shte nje ngjyre optimizmi dhe eshte efikase si je ngjyre stimuluese diellore.

Sjell qartesi

Nenësit, ne veçanti, kane nevoje per nje mjedis dinamik dhe stimulues per te rritur dhe formuar intelektin e tyre.

Ne hapesirat qe kane funksion loje dhe pune aktive, jane perdorur ngjyrat dhe tonalitetet e ngrohta midis te verdhes se lehte, te verdhes ne portokalli ose portokalli te hapur sepse stimulojne prodhimin e adrenalines, dhe per rjedhoje ndikojne ne krijmtarine dhe ne kapacitetet motorike.

## PRERJET E OBJEKTIT TE PROPOZUAR



➤ PAMJET NE 3D









Shoqeria "Ersi/M" shpk

ADMINISTRATOR

Gezim Goxhaj

ARKITEKT

Erald Goxhaj Lic. A.2613